



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 31.01.2018

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ATLANTI” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 57, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 138, datë 21.11.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, me propozim të Zyrës së Licencimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 38, të statutit së shoqërisë së sigurimit “Atlantik” sh.a., si rezultat i zmadhimit të kapitalit, me këtë përmbajtje:

Neni 38

Kapitali themeltar

- 38.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 777,468,731 lekë (Shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatë qind e tridhjetë e një) lekë. Ai është i ndarë në 77,746 (Shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetë e gjashtë) aksione nominale të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10.000,112 lekë, për çdo aksion.
- 38.2 Aksionet janë të numëruara nga numri 1 deri 77,746 përfshirë numrin e fundit të aksionit.
- 38.3 Aksioneri i vetëm z. Dritan Çelaj zotëron aksionet nga 1 deri në 77.746
- 38.4 Përbërja e kapitalit themeltar të shoqërisë është si më poshtë vijon:

Emër	Mbiemër	Nr. i aksioneve	Vlera në lekë
Dritan	Çelaj	100%	777.468.731

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI